

Sfidat e Integrimit European të Vëndit: Një Vështrim Mbi Kostot dhe Përfitimet

**Përgatitur nga
Dr. Selami Xhepa
Menaxher i Kërkimeve
Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT)**

Ky material është përgatitur për tryezën e diskutimit me temë: “Shqipëria dhe Bashkimi European – Zona e Re e Tregtisë së Lirë”

Ky aktivitet është organizuar nga ACIT me mbështetjen financiare të USAID dhe Fondacionit Gjerman Friedrich Ebert.

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit ku punon dhe donatorëve mbështetës të këtij projekti.

Tiranë, Nëntor 2004

Konteksti dhe dimensionet e politikave tregtare

Që nga përfundimi i dy luftrave botërore, përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të krijuar më shumë stabilitet për planetin tonë, janë drejtuar jo vetëm në krijimin e strukturave të sigurimit kolektiv dhe blloqeve ushtarake rajonale, por dhe në promovimin e paqes nëpërmjet zhvillimit dhe ruajtjes së stabilitetit të ekonomisë botërore. Krizën e Madhe (1929-1933) dhe shkaqet e luftrave, studjuesit i lidhin, midis të tjerash, dhe me faktin se politikat tregtare të kombeve gjatë këtyre viteve kishin ngritur mure tarifore mjaft të larta, duke e bërë të pamundur tregtinë midis tyre. Për këto arsye, dimensionet e politikave ekonomike e tregtare duheshin rikonsideruar. Ndërsa u krijuan institucionet ndërkombëtare që do të koordinonin politikat ekonomike për të garantuar stabilitetin monetar global (Fondi Monetar Ndërkombëtar) dhe do të nxisin zhvillimin ekonomik të kombeve nëpërmjet dhënies së kredive për zhvillim (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, më vonë e njohur si Banka Botërore), në planin e politikave tregtare përpjekjet e para shënohen po në këto vite të pas luftës së dytë botërore. Megjithëse dështuan përpjekjet për të krijuar një Organizatë Ndërkombëtare të Tregtisë (për shkak të mos miratimit nga Kongresi Amerikan), u krijua një Marrëveshje e Përgjithshme për Tregtinë dhe Tarifat (GATT). Përpjekjet në kuadër të GATT për thellimin e liberalizimit të tregtisë globale dhe të krijimit të një kuadri të unifikuar që rregullojnë tregtinë midis kombeve, kanë vazhduar në raundet e shumta të negociatave mes vendeve nënshkruese¹ (tetë gjithësej), deri në krijimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, në vitin 1995. Aktualisht, OBT ka lançuar një raund të ri negociatash, i njohur si “Axhenda e Zhvillimit Doha”. Ajo çfarë është e re në këtë raund është se liberalizimi pritet të shtrihet në sektorët deri tani të mbrojtur nga vendet e zhvilluara, si bujqësia dhe industria tekstile që pritet të sjellin më shumë përfitime për vendet në zhvillim.

Rezultati i negociatave në kuadrin e sistemit global të tregtisë kanë çuar në një reduktim të ndjeshëm të mbrojtjeve tarifore. Që në fund të viteve '60-të, nivelet e tarifave doganore ishin vetëm një fraksion i niveleve të para GATT-it. Nivelet aktuale të aplikuara të tarifave doganore në vendet e zhvilluara variojnë (sipas vendeve) në 3-5 për qind, me disa përjashtime për sektorë (disa produkte të bujqësisë dhe industrisë tekstile) të ndjeshëm (ku tarifat arrijnë deri në 15 për qind). Ndësa mbrojtjet tarifore vazhdojnë të jenë mjaft të larta në vendet në zhvillim, ku niveli mesatar i tarifave të aplikuara arrin në mbi 13 për qind, siç demonstrohen në tabelën 1.

¹ GATT vepronte si një marrëdhënie kontraktore mes palëve. Duke mos qenë një institucion, GATT nuk kishte dhe vende anëtare, por thjesht nënshkrues të marrëveshjes. Në dallim, OBT është organizatë e përbërë nga shtete anëtare.

Tabela 1: Tarifat doganore të aplikuara dhe të angazhuara, pas Raundit të Uruguajt; %					
	Grupet e produkteve	Vendet e Industrializuara		Vendet në zhvillim	
		Tarifat e aplikuara	Tarifat e angazhuara	Tarifat e aplikuara	Tarifat e angazhuara
1	Prod. Bujq., përjashtuar peshkun	5.2	7.2	18.6	19.9
2	Peshku dhe produkte të tij	4.2	4.9	8.6	25.9
3	Nafta	0.7	0.9	7.9	8.4
4	Druri, letra dhe mobilje	0.5	0.9	8.9	10.3
5	Tekstile dhe veshje	8.4	11.0	21.2	25.5
6	Lekura, plastika dhe veshje këmbësh	5.5	6.5	14.9	15.4
7	Metalet	0.9	1.6	10.8	10.4
8	Prodh. Kimike dhe fotografike	2.2	3.6	12.4	16.8
9	Pajisje transporti	4.2	5.6	19.9	13.2
10	Makineri jo-elektrike	1.1	1.9	13.5	14.5
11	Makineri elektrike	2.3	3.7	14.6	17.2
12	Prod.minerale; metale te shtrenjta	0.7	1.0	7.8	8.1
13	Prod.tjera industriale, pa specif. diku tjetër	1.4	2.0	12.1	9.2
	Mallrat industriale	2.5	3.5	13.3	13.3
	Gjithe produktet	2.6	3.7	13.3	13.0

(Shënim: tarifat sipas pesha tregtare, duke përjashtuar tregtinë brenda zonave të tregtisë së lirë. Tarifat e aplikuara janë ato të vitit bazë ndërsa tarifat e angazhuara janë ato do të aplikohen që nga fillimi nga zbatimi; prandaj në disa raste tarifat e aplikuara mund të jenë më të mëdha se ato të angazhuara). Burimi: B. Hoekman, A. Mattoo and P. English edit., “Development, Trade and the WTO – A Handbook”, The World Bank, 1998.)

Dimensioni i dytë i politikave tregtare janë rritja e barrierave jo-tarifore, si një mjet i mbrojtjes së industrive. Rënia e rolit të tarifave si instrumente të politikave tregtare është shoqëruar proporcionalisht me rritjen e rëndësisë relative të masave jo-tarifore. Për këto arsye, ndërsa Raundi i Uruguajt i Organizatës Botërore të Tregtisë e përqëndroi vëmendjen në reduktimin e barrierave tarifore ndaj tregtisë, në Raundin e Dohas të OBT, paralelisht me reduktimin e tarifave doganore dhe mbrojtjeve të tjera tarifore për sektorin e bujqësisë dhe industrisë tekstile, kryesisht nga vendet e zhvilluara, një vëmendje e veçantë i kushtohet lehtësimit të tregtisë. Masat që lidhen me lehtësimin e tregtisë janë me efekte të rëndësishme për rritjen e tregtisë dhe krijojnë efekte pozitive në të ardhurat e qytetarëve, për shkak të reduktimit të kostove të transaksionit².

Dimensioni i tretë janë rritja e rajonalizimit dhe krijimi i blloqeve tregtare midis rajoneve ose marrëveshje tregtare preferenciale mbi baza bilaterale. Tashmë janë nënshkruar³ më shumë se 230 marrëveshje të tilla midis vendeve të ndryshme, nga vetëm 50 që ekzistonin në vitin 1990.

² Për një vlerësim të efekteve të masave të lehtësimit të tregtisë, shih studimin me temë “Lehtësimi i Procedurave Doganore dhe i Marrëdhënieve të Biznesit me Administratën Doganore”, grup autorësh, ACIT, 2004.

³ World Bank, 2004 “Global Economic Prospects, 2005”.

Ky ndryshim në sistemin e tregtisë globale është frymëzuar kryesisht nga sukcesi i padiskutueshëm i Komunitetit Evropian, nga ndryshimi në qëndrimin e SHBA-së ndaj krijimit të blloqeve tregtare rajonale kryesisht⁴ në kundëveprim ndaj suksesit të BE-së dhe tendencave liberalizuese në nivel global që u shënuan me shembjen e sistemit komunist. Fryma e liberalizimit në ekonomi u shtri praktikisht thuajse në gjithë globin, me përjashtime të rralla (si Kubë, Kore e Veriut, etj.). Tema e globalizimit përkundrejt rajonalizimit (ose siç emëtrohet shpesh “liberalizimi kompetitiv”) është tashmë një temë mjaft e preferuar në diskutimet e sotme mes akademikëve të ekonomisë politike, të tregtisë dhe marrdhënieve ndërkombëtare.

Shqipëria përballë këtyre zhvillimeve

Liberalizimi i regjimit tregtar ishte para së gjithash pjesë e procesit të tranzicionit. Në këtë kuptim, reduktimi tarifor ka qenë një konstante e politikës tregtare të vendit. Siç rezulton nga tabela 2, përqindja e linjave tarifore që ju janë nënshtruar nivelit maksimal të tarifës kanë ardhur duke u reduktuar, ndërsa është rritur përqindja e linjave tarifore që i nënshtrohen niveleve minimale (ose zero) të tarifave. Nivelet e tarifave janë të krahasueshme me ato që aplikohen në vendet e rajonit, siç pasqyrohen në tabelën 3.

Tabela 2: Përqindja e linjave tarifore (sipas klasifikimit të Sistemit të Hamonizuar) sipas niveleve të tarifave

<i>Përqindja e linjave tarifore për vitet</i>		
Niveli tarifës	2003	2004
0%	17.2	25.5
2%	30.3	28.0
10%	25.1	23.3
15%	27.5	23.2

Burimi: Llogaritje të bëra nga ACIT, 2004.

Tabela 3: Nivelet e tarifave dogabore në vendet e rajonit

	Nivelet tarifore, 2002		Shkallët
	Mesatare e thjeshtë	Sipas peshave të importit	
Shqipëria	8.1	na	0, 2, 10, 15
B&H	6.8	na	0, 5, 10, 15*
Kroacia	7	7	100+rates
Serbia	9.5	8	1, 5, 10, 15, 20, 30
Mali I Zi	3	na	1, 3, 5, 10, 15
Kosova	10	10	Uniform
Tarifa specifike për 250 linja tarifore në produktet bujqësore			
Burimi : World Bank regional report, June 2002			

Nga ana tjetër, vendi ynë u bë pjesë e sistemit global të tregtisë me anëtarësimin në OBT, që nga vitit 2000.

⁴ Jeffrey A. Frankel, 1997 “Regional Trading blocs in the new world economic system”, a publication of Institute for International Economics, Washington D.C., October 1997; page 5.

Ndërsa që nga viti 2002, ajo ka filluar të liberalizojë tregtinë edhe mbi baza preferenciale, fillimisht me vendet e rajonit dhe më vonë edhe me Bashkimin Evropian. Megjithëse tregtia me vendet e rajonit është në nivele modeste, objektivi themelor i rrjetit të MTL-ve është që të inkurajojë marrëdhëniet ekonomike e tregtare midis tyre dhe të nxisë zhvillimin ekonomik të rajonit nëpërmjet përmirësimit të klimës së investimeve dhe tërheqjes së investimeve të huaja direkte.

Evropa është partneri ynë natyror tregtar dhe ndryshimet në regjimin tregtar do të pasqyrohen në ndryshimet në ekonominë e brendshme. Në sot realizojmë mbi 90 për qind të volumit të eksporteve dhe rreth 70 për qind të volumit të importeve me vendet anëtare të BE-së. Me këto shifra, Bashkimi Evropian përfaqëson partnerin tregtar më të rëndësishëm të vendit tonë. Për rrjedhojë, regjimi tregtar me Bashkimin Evropian është i një rëndësie të veçantë.

E thënë me një fjalë, liberalizimi i regjimit tregtar me BE-në duhet parë si një proces i kalimit nga asimetria drejt simetrisë. Marrëveshje preferenciale i janë akorduar vendit tonë dhe disa prej vendeve të rajonit që nga viti 1992. Ky regjim është bërë gjithnjë e më i favorshëm, duke ofruar më shumë koncensione dhe rritur më shumë aksesin në treg të produkteve me origjinë shqiptare. Ndërkohë, duke filluar që nga shtatori i vitit 2001, Bashkimi Evropian po zbaton Regjimin Asimetrik Tregtar (me vendimin 2007/2000 të Komisionit Evropian), që është dhe regjimi më preferencial që BE i ka akorduar vendeve të tjera. Praktikisht, thujtë të gjithë produktet nga Shqipëria dhe vendet e rajonit mund të eksportohen në tregjet e BE-së pa tarifa doganore, me përjashtim të një numri të kufizuar produktesh bujqësore dhe produkteve të industrisë tekstile, për të cilën janë akorduar kuota. Megjithatë, siç është demonstruar gjerësisht në analizat e tregtuesve të tregtisë së jashtme, Shqipëria thujtë asnjëherë nuk ka qenë në gjendje të përmbushë kuotat e akorduara. Kjo është kryesisht rrjedhojë e faktit se ekonomia e vendit ka vazhduar të jetë subjekt i kufizimeve në anën e ofertës së brendshme, performancave të reformave strukturore në ristrukturimin e ndërmarrjeve dhe hyrjen e ndërmarrjeve të reja lokale apo të huaja në sektorët e eksporteve.

Ajo çfarë pritet të ndodhë me mbylljen e negociatave për lëvizjen e mallrave (kapitujt përkatës të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit), do të jetë (kryesisht) liberalizimi nga pala shqiptare i importeve nga vendet e BE-së duke arritur simetrinë e sistemit dhe krijimin brenda një periudhe kohore (deri në fund të vitit 2008) të një zone të lirë tregtare. Praktikisht, me fillimin e dekadës së re, zona e tregtisë së lirë do të shtrihet në shkëmbimet me pothuajse gjithë partnerët tregtar të kontinentit tonë.

Që nga fillimi i vitit të ardhshëm⁵, niveli i tarifave doganore të importeve nga Bashkimi Evropian do të reduktohet ndjeshëm, për të rënë deri në fund të periudhës tranzitore në nivele të përafërta me atë të vendeve që tashmë kanë përfunduar këtë proces, si Bullgaria apo Sllovenia, me nivele tarifore siç pasqyrohen në tabelën 2. Në këtë tabelë janë paraqitur normat mesatare të tarifave doganore të vendeve përkatëse kundrejt gjithë vendeve të tjera (me tarifën e kombit më të favorizuar: MFN) dhe ndaj importeve nga vendet e Bashkimit Evropian (EU).

⁵ Kjo do të varet nga futja në veprim e Kapitujve të liberalizimit të tregtisë së mallave industriale dhe bujqësore, si pjesë të MSA që hynë në fuqi me një vendim të Komisionit Evropian, pavarësisht nga ratifikimi dhe hyrja në fuqi e gjithë MSA.

Tabela 4: Normat mesatare tarifore, 2002, %	MFN	EU
Shqipëria	7.5	7.5
Bosnje Herzegovina	5.1	5.1
Bullgaria	7.9	2.5
Kroacia	4.3	1.4
Maqedonia	12.3	8.0
Rumania	14.5	3.7
Serbia&Mali Zi	8.2	8.2
Sllovenia	7.6	1.2

Në këtë këndvështrimi, perspektivat e politikës tregtare pritet të orientohen drejt thellimit të procesit të liberalizimit.

Sfidat që duhet të përballohen

Një ndër ndikimet e drejtpërdrejta të lëvizjes drejt një integrimi më të thellë, do të jetë reduktimi i të ardhurave buxhetore (**impalikimet fiskale**) nga tarifatat doganore të importit.

Pesha e të ardhurave buxhetore nga tarifatat doganore ka rënë vazhdimisht, nga 11.3 për qind e të ardhurave tatimore në vitin⁶ 1999, në 9.5 për qind në vitin 2003. Të ardhurat doganore sidoqoftë, vazhdojnë të mbeten një burim i rëndësishëm i të ardhurave në raport me ekonominë më të integruara. Kështu, në Slloveni dhe Bullgari ato zënë respektivisht 0.6 dhe 0.7 për qind të PBB-së, nga 2 për qind në Shqipëri (të dhënat e vitit 2002 – Paketa fiskale – 2004; Ministria e Financave, Dhjetor 2003).

Për rrjedhojë, në një perspektivë afatmesme pritet që ky burim i të ardhurave të buxhetit të reduktohet gradualisht, duke kërkuar që të merren masa për një riauxhustim fiskal. Është e nevojshme që reformat në sistemin fiskal të vendit të synojnë zgjerimin e bazës së tatimpaguesve, jo vetëm për të kompensuar humbjen e këtij burimi të të ardhurave, por duke synuar arritjen e niveleve të të ardhurave buxhetore me qëllim thellimin e konsolidimit fiskal të vendit dhe rritjes së niveleve të investimeve publike, për të përballuar nevojat që diktohen në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Social të vendit.

Ndikimi më i rëndësishëm pritet të transmetohet nëpërmjet **intensifikimit të presionit konkurrencial** mbi biznesin e vendit. Firmat që nuk do të jenë në gjendje t'i bëjnë ballë, do të dalin nga biznesi, duke krijuar probleme të papunësisë. Megjithatë reformat e liberalizimit dhe ato strukturore të ndërmarra gjatë gjithë tranzicionit, kanë bërë që në një masë të madhe efektet e konkurrencës së huaj të kenë dhënë efektet e tyre, nga thellimi i proceseve të integritit mund të pritet që këto efekte të vazhdojnë të jenë në veprim.

Në këtë këndvështrim, ndërsa shteti duhet të kujdeset për zbutjen e pasojave sociale të krijuara, komuniteti i biznesit duhet të mendojë se si të përshtatet në kushtet e reja ndaj kërkesave, standarteve dhe rregullave që na imponohen nga këto procese, më tepër se sa të kërkojë të gjejë shtigje se si t'iu shmanget atyre. Ne duhet të vlerësojmë se si mund të riorganizojmë vetveten dhe vlerat tona që t'iu përshtaten sistemit të vlerave të komunitetit

⁶ Llogaritur sipas të dhënave të statistikave fiskale të Ministrisë së Financave, www.minfin.gov.al

ku do të aderojmë. Për biznesin, kjo nënkupton se si mund t'i bëj ballë një presioni konkurrencial edhe më të fortë se deri tani.

Nuk ka rrugëzgjidhje tjetër që të përballohet ky presion veçse duke qenë më konkurrues se konkurrentët tanë. Për rrjedhojë, **aftësia e ekonomisë për të konkurruar**, që nënkupton aftësi të firmave shqiptare për të prodhuar mallra apo ofruar shërbime që plotësojnë testin e kërkesave të tregut, merr një prioritet të dorës së parë.

Padyshim që realizimi i një zone të tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian, si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit do të shoqërohet me një proces të rëndësishëm rialokues të burimeve në ekonominë e vendit, drejt sektorëve/produkteve që kanë avantazhe relative në raport me BE-në. Rrjedhimisht, ato përmirësojnë mirëqenien e vendit, duke qenë se alokojnë burimet drejt një përdorimi më eficient. Po kështu, ato janë me efekte në termat e tregtisë dhe rrjedhimisht ndikojnë në bilancin kursime-investime të vendit.

Sipas disa vlerësimeve të kryera nga studjues të Bankës Botërore⁷, rezulton se veprimi i kombinuar i MSA dhe MTL-ve me rajonin, sjellin një efekt pozitiv në treguesin e mirëqenies në nivelin mbi 3% të PBB-së (në termat dinamik), një rritje të pagave prej 5.68%; rritje të eksporteve me mbi 50% dhe importeve me rreth 6 për qind.

Nga një analizë e thelluar sektoriale e ndikimeve të MSA rezulton se mund të priten rialokime nga sektori i agroindustrial drejt industrisë së veshjeve dhe përpunimit të lëkurës dhe ndërtimit, sektorë që pritet të marrin më shumë zhvillim si rrjedhojë e këtyre proceseve. Efekte të njëjtës natyrë do të shënohen dhe nga MTL-të me rajonin, por në një shkallë shumë më modeste.

Ky proces rialokimi i burimeve ekonomike natyrisht që do të shoqërohet me rialokime të fuqisë punëtore drejt sektorëve industrial si dhe zhvendosje të popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane. I gjithë ky proces do të ketë kostot e saj që është e nevojshme të monitorohen dhe të merren masat e nevojshme për të asistuar firmat dhe punonjësit në këtë proces rialokimi.

Në një perspektivë më afatgjatë, sfidat e integritimit do të nënkuptojnë dhe politikat në funksion të arritjes së **konvergjencës në termat makroekonomike** me vendet e BE-së. Reduktimi i deficitit fiskal, menaxhimi kursit të këmbimit të monedhës në raport me euron, mbajtja e normave të ulëta të inflacionit dhe konvergimi i normave të interesave të sistemit bankar, janë dhe kriteret tashmë të njohura që vendi duhet të realizojë. Natyrisht që ekonomia dhe konsumatorët do të përfitojnë nga politika të tilla, pasi ato kontribuojnë drejtpërdrejtë në rritjen e stabilitetit ekonomik e monetar, rritjen e aksesit në tregjet e kapitaleve, rritjen e aftësisë së ekonomisë për huamarrje, pra dhe në më shumë investime vendase dhe të huaja dhe punësim.

⁷ Vlerësime të kryera me metodat e Ekuilibrit të Përgjithshëm (CGE) duke aplikuar programin GTAP.

Mbyllje

Nuk ka dyshim se integrimi, përveçse një aspiratë e shprehur mbarëkombëtare, përbën dhe një sfidë për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare. Çështja shtrohet se me çfarë shpejtësie duhet të lëvizim drejt BE-së. Shqipëria duhet të lëvizë me shpejtësi përpara për të kapur kohën e humbur dhe të mos mbetet më pas se vendet e tjera të rajonit.